- Mos e prekni spinën me duar të njoma! Mos e hiqni asnjëherë nga priza duke tërhequr kordonin, gjithmonë hiqeni duke kapur spinën.
- Mos përdorni kordonë zgjatues, pajisje me shumë priza apo adaptorë për ta lidhur tharësen me energjinë në mënyrë që të ulni rrezikun e zjarrit dhe goditjes elektrike.
- Priza e kabllor së energjisë duhet të jetë lehtësisht e arritshme pas instalimit.

Udhëzime të rëndësishme për sigurinë dhe mjedisin



Kabllloja e rrjetit e dëmtuar duhet të ndërrohet duke njoftuar shërbimin e autorizuar.



Nëse tharësja është me defekt, ajo nuk duhet të përdoret derisa të riparohet nga një agjent shërbimi i autorizuar. Ka rrezik të goditjes elektrike!

1.1.2 Siguria e produktit



Çështje që duhet të merren në konsideratë për rrezikun e zjarrit:

Robat apo artikujt e specifikuar më poshtë nuk duhet të thahen

- në tharëse duke marrë në konsideratë rrezikun e zjarrit.
- Robat e palara, artikujt e ndotur me vaj, aceton, alkool, karburant, vajguri, largues të njollave, terpentinë, parafinë apo largues të parafinës, duhet të lahen në ujë të ngrohtë me detergjent të bollshëm përpara se të thahen në tharëse.

Për këtë arsye dhe veçanërisht artikujt që përmbajnë njollat e specifikuara më sipër duhet të lahen shumë mirë, për ta bërë këtë përdorni detergjente të përshtatshëm dhe zgjidhni një temperaturë të lartë larjeje.

Udhëzime të rëndësishme për sigurinë dhe mjedisin



Rrobat apo artikujt e specifikuar më poshtë nuk duhet të thahen në tharëse për shkak të rrezikut të zjarrit:

- Veshje apo jastëkë të përforcuar me gomë peshku (shkumë qumështi), mbulesat e dushit, tekstilet që i rezistojnë ujit, materiale përforcues prej gome dhe mbushje të gomës së peshkut.
 - Veshjet që pastrohen me kimikate industriale. Artikuj të tillë si çakmakët, shkrepëset, monedhat, pjesët metalike, gjilpërat etj. mund të dëmtojnë kazanin apo të çojnë në probleme me funksionimin. Prandaj kontrolloni të gjitha rrobat që do të vendosni në tharëse.
- Mos e ndalni asnjëherë tharësen tuaj përpara se të ketë përfunduar programi. Nëse ju duhet ta bëni patjetër, hiqni shpejt të gjitha rrobat dhe hapini që të largohet nxehtësia.



Veshjet të cilat lahen në mënyrë të papërshtatshme mund të ndizen vetë dhe madje mund të ndizen edhe pasi të përfundojë tharja.

- Duhet të siguroni ajrosje të mjaftueshme me qëllim që të parandaloni daljen e gazeve nga pajisjet që punojnë me lloje të tjera të karburanteve duke përfshirë flakët e hapura nga akumulimi në dhomë për shkak të efektit të zjarrit kthyes.



Të brendshmet të cilat përmbajnë përforcues metalikë nuk duhet të thahen në tharëse. Tharësja mund të dëmtohet nëse përforcuesit metalikë lirohen apo shpëputen gjatë tharjes.

Udhëzime të rëndësishme për sigurinë dhe mjedisin



Përdorni zbutës apo produkte të ngjashme në përputhje me udhëzimet e prodhuesve të tyre.



Pastroni gjithmonë filtrin e linjtë para apo pas çdo ngarkese. Mos e përdorni asnjëherë tharëse pa instaluar filtrin e linjtë.

- Mos u përpiqni asnjëherë që ta riparoni vetë tharësen. Mos kryeni asnjë riparim apo procedurë zëvendësimi në pajisje edhe nëse e dini apo keni aftësinë për ta kryer procedurën e kërkuar përveç rastit kur sugjerohet në mënyrë të qartë në udhëzimet e përdorimit apo në manualin e shërbimit të bërë publik. Në rast të kundërt, mund të vini në rrezik jetën tuaj dhe të tjerëve.
- Nuk duhet të ketë derë që mbyllet, rrëshqitëse apo menteshë që të bllokojë hapjen e derës së ngarkimit në vendit ku do të instalohet tharësja.
- Instaloheni tharësen tuaj në vende të përshtatshme për përdorim shtëpiak. (banjë, ballkon i mbyllur, garazh etj.)
- Sigurohuni që kafshët shtëpiake të mos hyjnë në tharëse. Kontrolloni pjesën e brendshme të tharëses përpara se ta vini në punë.
- Mos u varni në derën e ngarkimit të tharëses tuaj kur është e hapur, në rast të kundërt mund të rrëzohet.
- Mbetjet e linjta nuk duhet të lejohen që të grumbullohen brenda tharëses.

Udhëzime të rëndësishme për sigurinë dhe mjedisin

1.2 Montimi mbi makinën larëse

- Duhet të përdoret një pajisje mbërthyes midis të dyja pajisjeve kur tharësja instalohet mbi makinën larëse. Pajisja mbërthyes duhet të instalohet nga një agjent shërbimi i autorizuar.
- Pesha totale e makinës larëse dhe tharëses - me ngarkesë të plotë - kur janë të vendosura mbi njëra-tjetrën arrin afërsisht në 180 kilogramë. Vendosini produktet në një dyshe të ngurtë e cila ka kapacitet të mjaftueshëm mbajtës!



Makina larëse nuk mund të vendoset mbi tharëse. Kushtojini vëmendje paralajmërimeve të mësipërme gjatë instalimit të makinës tuaj larëse.

Tabela e instalimit për makinën larëse dhe tharësen

Thellësia e tharëses	Thellësia e makinës larëse						
	62 cm	60 cm	54 cm	50 cm	49 cm	45 cm	40 cm
54 cm	Mund të instalohet					Mund të instalohet	Nuk mund të instalohet
60 cm	Mund të instalohet					Nuk mund të instalohet	

Udhëzime të rëndësishme për sigurinë dhe mjedisin

1.3 Përdorimi i synuar

- Tharësja është projektuar për përdorim shtëpiak. Nuk është e përshtatshme për përdorim në biznes dhe nuk mund të përdoret jashtë përdorimit të saj të synuar.
- Përdorenit tharësen vetëm për të tharë rroba të cilat kanë shenjën përkatëse.
- Prodhuuesi heq dorë nga përgjegjësia që lind nga përdorimi apo transporti jo i duhur.
- Jeta e shërbimit të tharëses që keni blerë është 10 vjet. Gjatë kësaj periudhe do të ketë në dispozicion pjesë këmbimi që tharësja të funksionojë siç duhet.

1.4 Siguria për fëmijët

- Materialet ambalazhuese janë të rrezikshme për fëmijët. Mbajini materialet ambalazhuese larg fëmijëve.
- Produktet elektrike janë të rrezikshme për fëmijët. Mbajini fëmijët larg produktit kur ai është në punë. Mos i lejoni ata që ta ngacmojnë tharësen. Përdorni kyçjen për fëmijët me qëllim që t'i parandaloni ata që ta ngacmojnë tharësen.




Kyçja për fëmijët gjendet në panelin e kontrollit.
(Shihni Kyçjen për fëmijët)

- Mbajeni derën e ngarkimit të mbyllur edhe kur tharësja nuk është në përdorim.

Udhëzime të rëndësishme për sigurinë dhe mjedisin

1.5 Pajtimi me rregulloren e WEEE dhe asgjësimi i produktit



Ky produkt është në përputhje me Direktivën evropiane WEEE (2012/19/EU). Ky produkt ka një simbol klasifikimi për pajisjet elektrike dhe elektronike të përdorura (WEEE).

Ky produkt është prodhuar me pjesë dhe materiale me cilësi të lartë, të cilat mund të ripërdoren dhe janë të përshtatshme për riciklim. Mos e hidhni produktin e përdorur bashkë me mbeturinat familjare dhe mbeturinat e tjera në fund të jetës së shërbimit të produktit. Çojeni atë në qendrën e grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Këshillohuni me autoritetet lokale për të mësuar mbi këto qendra të grumbullimit.

1.6 Pajtimi me direktivën RoHS:

Produkti që keni blerë është i pajtueshëm me Direktivën EU RoHS (2011/65/EU). Ai nuk përmban materiale të dëmshme dhe të ndaluara të specifikuara në Direktivë.

1.7 Informacione për ambalazhin

Materialet e paketimit të produktit prodhohen nga materiale të riciklueshme në përputhje me Rregulloret tona kombëtare për mjedisin. Mos i hidhni materialet e paketimit bashkë me mbeturinat familjare ose mbeturinat e tjera. Çojini ato te pikat e grumbullimit për materialet e paketimit të përcaktuara nga autoritetet lokale.

Udhëzime të rëndësishme për sigurinë dhe mjedisin

1.8 Specifikimet teknike

Lartësia (min. / maks.)	84,6 cm / 86,6 cm*
Gjerësia	59,5 cm
Thellësia	54 cm
Kapaciteti (maks.)	7 kg**
Pesha neto (përdorimi i derës plastike të përparme)	33,5 kg
Pesha neto (përdorimi i derës së xhamit të përparme)	36 kg
Voltazhi	Shiko etiketën e tipit***
Energjia nominale në hyrje	
Kodi i modelit	

* Lartësia min.: Lartësia me këmbë të rregullueshme të mbyllura.

Lartësia maks.: Lartësia me këmbë të rregullueshme të hapura në maksimum.


** Thani ngarkesën e rrobave para larjes.

*** Etiketa e tipit gjendet në pjesën e pasme të derës së ngarkimit.

	Specifikimet teknike të tharëses janë objekt i ndryshimeve pa një njoftim paraparak për të përmirësuar cilësinë e produktit.
	Figurat në këtë manual janë skematike dhe mund të mos përputhen me saktësi me produktin.
	Vlerat e shënuara në treguesit në tharëse ose në dokumentacione të tjera të botuara që shoqërojnë tharësen janë marrë në laboratorë në përputhje me standardet përkatëse. Këto vlera mund të ndryshojnë në varësi të kushteve operative dhe mjedisore.

2 Tharësja juaj

2.1 Përmbajta e ambalazhit



1. Tubi i shkarkimit të ujit *
2. Sfungjeri rezervë për sirtarin e filtrit*
3. Manuali i përdoruesit
4. Koshi i tharjes*
5. Manuali i përdorimit të koshit të tharjes*

*Mund të ofrohet së bashku me pajisjen tuaj në varësi të modelit.

3 Instalimi

Përpara se t'i telefononi shërbimit të autorizuar më të afërt për instalimin e tharësës, sigurohuni që instalimet elektrike dhe shkarkimi i ujit të jenë të përshtatshme duke iu referuar manualit të përdorimit. **(Shihni 3.3 Lidhja me tubin e shkarkimit dhe 3.5 Lidhja elektrike)** Nëse ato nuk janë të përshtatshme, kontaktoni me një elektrikist dhe teknik të kualifikuar për të kryer rregullimet e nevojshme.



Përgatitja e vendndodhjes së tharësës si dhe instalimet elektrike e të ujit të papastër janë përgjegjësi e klientit.



Përpara instalimit, kontrolloni me sy nëse tharësja ka ndonjë defekt. Nëse tharësja është e dëmtuar, mos e instaloni. Produktet e dëmtuara përbëjnë rrezik për shëndetin tuaj.

3.1 Vendndodhja e përshtatshme për instalimin

- Instaloheni tharësen në një sipërfaqe të qëndrueshme dhe në nivel.
- Tharësja është e rëndë. Mos e zhvendosni vetë.
- Vëreni në punë tharësen në një mjedis të ajrosur dhe pa pluhura.
- Hapësira midis tharësës dhe sipërfaqes nuk duhet të reduktohet nga materiale të tilla si tapetat, druri dhe shiritat.
- Mos e mbuloni rrjetën e ajrosjes së tharësës.
- Nuk duhet të ketë derë që mbyllet, rrëshqitëse apo menteshë që të bllokojë hapjen e derës së ngarkimit në vendit ku do të instalohet tharësja.
- Pasi tharësja të jetë instaluar, ajo duhet të qëndrojë në të njëjtin vend ku është bërë lidhja e saj. Kur të instaloni tharësen sigurohuni që pjesa e pasme të mos prekë askund (rubinet, prizë, etj).
- Vendoseni tharësen të paktën 1 cm larg nga skajet e pajisjeve të tjera.

- Tharësja juaj mund të punojë në temperatura midis +5°C dhe +35°C. Nëse kushtet e funksionimit janë jashtë kësaj game, funksionimi i tharësës do të ndikohet negativisht dhe mund të dëmtohet.
- Sipërfaqja e pasme e tharësës duhet të vendoset pas murit.




Mos e vendosni tharësen mbi kabllon e energjisë.

3.2 Heqja e grupit të sigurisë së transportit



Hiqni grupin e sigurisë së transportit përpara se ta përdorni tharësen për herë të parë.

Hapni derën e ngarkimit. Brenda kazanit duhet të ketë një qese najloni që përmban një copë polisteroli. Mbajeni nga ana e shënuar me **XX XX**. Tërhiqeni najlonin drejt vetes tuaj dhe hiqni grupin e sigurisë së transportit.



Kontrolloni që asnjë pjesë e grupit të sigurisë së transportit të mos mbetet brenda kazanit.

3.3 Lidhja me tubin e shkarkimit

- Në produktet e pajisura me njësi kondensimi, uji grumbullohet në depozitën e ujit gjatë ciklit të tharjes. Duhet të shkarkoni ujin e grumbulluar pas çdo cikli të tharjes.
- Mund ta shkarkoni drejtpërdrejt ujin e grumbulluar nëpërmjet tubit të shkarkimit të ujit të siguruar së bashku me produktin, në vend që të shkarkoni periodikisht ujin e grumbulluar në depozitën e ujit.


Instalimi

Lidhja e tubit të shkarkimit të ujit

1-2 Tërhiqni me duar tubin në pjesën e pasme të tharësës me qëllim që ta shkëputni nga vendi ku është lidhur. Mos përdorin asnjë vegël për të hequr tubin.

3 Lidhni një skaj të tubit të shkarkimit me tharësen me pikën e lidhjes nga ku hoqët tubin e produktit në hapin e mëparshëm.

4 Lidhni skajin tjetër të tubit të shkarkimit me shkarkimin e ujit të papastër ose me lavamanin.



Mos i zhvidhosni asnjëherë këmbët nga foletë e tyre.

3.5 Lidhja elektrike

Për udhëzime specifike për lidhjen elektrike që kërkohet gjatë instalimit (**shihni 1.1.1 Siguria elektrike**)

3.6 Transporti i tharësës

1- Hiqni tharësen nga priza përpara se ta transportoni.

2- Shkarkoni të gjithë ujin që ka mbetur në tharëse.

3- Nëse është kryer lidhje e drejtpërdrejtë me shkarkimin e ujit, hiqni lidhjet me tubin.




Ju rekomandojmë që ta mbani tharësen në pozicionin me kokë sipër. Nëse nuk është e mundur që ta mbani pajisjen në pozicionin me kokë sipër, ju rekomandojmë që ta mbani të anuar nga pjesa e djathtë kur tharësja shihet përballë.

3.7 Ndërrimi i llambës së ndriçimit

Në rastin e përdorimit të një llambe ndriçuese në tharësen tuaj të rrobave Për të ndërruar poçin/LED-in e përdorur për ndriçim në tharësen tuaj, telefonojini shërbimit të autorizuar.

Llamba(t) e përdorur në këtë pajisje nuk është e përshtatshme për ndriçimin e dhomave të shtëpisë. Qëllimi i synuar i kësaj llambe është që të ndihmojë përdoruesin që të vendosë lehtësisht rrobat në tharëse. "Llambat e përdorura në këtë pajisje duhet të përballojnë kushte fizike ekstreme, si dridhjet dhe temperaturat mbi 50 °C."



Lidhja e tubit duhet të kryhet në një mënyrë të sigurt. Foleja e shkarkimit do të mbushet me ujë nëse tubi del nga foleja e tij gjatë shkarkimit të ujit.



Tubi i shkarkimit të ujit duhet të lidhet në një lartësi maksimumi 80 cm.



Sigurohuni që tubi i shkarkimit të ujit të mos jetë shkelur apo përthyer midis pikës së shkarkimit dhe pajisjes.

3.4 Rregullimi i këmbëve

Me qëllim që të siguroheni se tharësja funksionon me më pak zhurmë apo pa dridhje, duhet që ajo të qëndrojë në nivel dhe e balancuar në këmbët e saj. Balanconi pajisjen duhet rregulluar këmbët e saj. Rrotulloni këmbët nga e majta apo nga e djathta derisa tharësja të qëndrojë në nivel dhe e palëvizshme.

4 Përgatitja

4.1 Rrobat e përshtatshme për t'u tharë në tharëse

Veproni gjithmonë në përputhje me udhëzimet e shënuara në etiketat e rrobave. Thani vetëm rrobat të cilat kanë një etiketë që thotë se ato janë të përshtatshme për t'u tharë në tharëse dhe sigurohuni që të përzgjidhni programin e përshtatshëm.

SIMBOLET PËR THARJEN E RROBAVE											
	Simbolet për tharjen	 E përshtatshme për në tharëse	 Mos e hekuros	 Tharje sensitive / delikate	 Mos e thani me tharëse	 Mos e thani	 Mos e çoni në pastrim kimik				
 	Parametrat e tharjes	 Në çfarëdo temperature	 Në temperaturë të lartë	 Në temperaturë mesatare	 Në temperaturë të ulët	 Pa nxehtë	 Varen për t'u tharë	 Hapeni për t'u tharë	 Varen të lagur për t'u tharë	 Hapeni në hije për t'u tharë	 Mund të pastrohet në pastrim kimik
 HEKUROSI	Hekuros -										
	Me tharje ose me avull	Hekuroseni me temperaturë të lartë		Hekuroseni me temperaturë mesatare	Hekuroseni me temperaturë të ulët	Mos e hekurosni		Hekuroseni pa avull			
	Temperatura maksimale	200 °C		150 °C	110 °C						

4.2 Rroba që nuk janë të përshtatshme për t'u tharë në tharëse



Pëlhurat delikate të qëndisura, të leshtat, veshjet e mëndafshita, veshjet delikate dhe me vlerë, artikujt e papërshekueshëm nga ajri dhe tylet e perdet nuk janë të përshtatshme për t'u tharë në pajisje.

4.3 Përgatitja e rrobave për t'u tharë

- Rrobat mund të përzihen me njëra-tjetrën pas larjes. Ndajini ato përpara se t'i vendosni në tharëse.
- Thajini së prapthi rrobat të cilat kanë aksesore të tillë si zinxhirët.
- Mbërtheni zinxhirët, sustat, tokëzat dhe kopsat.

4.4 Gjëra që duhen bërë për të kursyer energji

Respektimi i informacioneve do t'ju ndihmojë që ta përdorni tharësen në mënyrë ekologjike dhe eficiente në lidhje me energjinë.


- Centrifugojini rrobat tuaja me shpejtësinë më të madhe të mundshme kur t'i lani. Në këtë mënyrë, shkurtohet koha e tharjes dhe reduktohet konsumi i energjisë.
- Ndajini rrobat në varësi të llojit dhe trashësisë. Thani së bashku të njëjtat lloje të rrobave. Për shembull, peshqirët e hollë të kuzhinës dhe mbulesat e tavolinës thahen më shpejt se peshqirët e banjës.
- Ndiqui udhëzimet në manualin e përdorimit për përzgjedhjen e programit.
- Mos e hapni derën e ngarkimit të pajisjes gjatë tharjes përveç rasteve kur kjo është e nevojshme. Nëse ju duhet patjetër që të hapni derën e ngarkimit, mos e mbani hapur për një kohë të gjatë.

Përgatitja

- Mos shtoni rroba të lagura ndërkohë që tharësja është në punë.
- Pastroni filtrin e linjtë përpara dhe pas çdo cikli të tharjes.
- Pastrojeni rregullisht kondensatorin të paktën një herë në muaj ose pas 30 cikleve të tharjes.
- Ajrosni mirë gjatë tharjes dhomën ku ndodhet tharësja.

4.5 Kapaciteti i duhur i ngarkimit

Ndiqui udhëzimet në “Tabelën e përzgjedhjes së programit dhe konsumit”. Mos ngarkoni më tepër rroba sesa vlerat e kapacitetit të treguara në tabelë.



Nuk rekomandohet që tharësja të ngarkohet me rroba që tejkalojnë nivelin e treguar në figurë. Rezultati i tharjes do të ulet nëse pajisja ngarkohet më tepër se ç'duhet. Për më tepër, tharësja dhe rrobat mund të dëmtohen.


Peshat në vijim janë marrë si shembull:

Rrobat	Peshat e përafërta (g)*
Batanije pambuku (dyshe)	1500
Batanije pambuku (teke)	1000
Çarçafë krevati (dyshe)	500
Çarçafë krevati (tek)	350
Mbulesa tavoline të mëdha	700
Mbulesa tavoline të vogla	250
Peceta çaji	100
Peshqirë banje	700
Peshqirë duarsh	350
Bluza	150
Këmisha pambuku	300
Këmisha	250
Fustane pambuku	500
Fustane	350
Xhinse	700
Shami (10 copë)	100
Bluza me mëngë të shkurtra	125

*Pesha e rrobave të thata përpara larjes.

5 Vënia në punë e produktit

5.1 Paneli i kontrollit



1. Çelësi i përzgjedhjes së programit
2. Treguesi i kohëzgjatjes së mbetur
3. Butoni Aktiv/Joaktiv
4. Butoni Nis/pezullo
5. Butoni i përfundimit të kohëzgjatjes
6. Butoni paralajmërues me tingull

5.2 Simbolet e ekranit



5.3 Përgatitja e pajisjes

1. Vëreni pajisjen në prizë
2. Vendosni rrobat brenda pajisjes.
3. Shtypni butonin Aktiv/Joaktiv
4. Kur pajisja ndizet për herë të parë, ndizet me programin (thatësia e kabinetit të pambuktë) e deklarimit.



Shtypja e butonit Aktiv/Joaktiv nuk tregon që programi nis. Shtypni butonin Nis / Pezullo për të nisur programin.

5.4 Përzgjedhja e programit

1. Përcaktoni programin e përshtatshëm nga grafiku më poshtë i cili përmban nivelet e tharjes.
2. Përzgjidhni programin që dëshironi duke përdorur çelësin e përzgjedhjes së programit.

Tharja shtesë	Vetëm rrobat e pambukta thahen në temperaturë normale. Rrobat e trasha dhe me shumë shtresa (peshqirët, çarçafët, xhinset, etj.) thahen në mënyrë të tillë që të vendosen në gardërobë pa u hekuros.
Të thara për në dollap	Rrobat normale (mbulesat e tavolinës, të brendshmet, etj.) thahen në mënyrë të tillë që të vendosen në gardërobë pa u hekuros.
Të thara për në dollap +	Rrobat normale (psh. mbulesat e tavolinës, të brendshmet, etj.) thahen në mënyrë të tillë që të vendosen në gardërobë por me shumë se opsioni i thatësisë për në gardërobë.
Tharje me hekur	Rrobat normale (këmishat, fustanet etj.) thahen në mënyrë të tillë që të jenë të gatshme për t'u hekuros.



Për informacione të detajuara shihni: „Përzgjedhja e programit dhe tabela e konsumit“.

5.5 Programet kryesore

Programet kryesore tregohen më poshtë në bazë të llojit të pëlthurës.

• Të pambuktat

Me këtë program thani rrobat rez-istuese. Ai than në temperaturë normale. Rekomandohet në përdorim për rrobat tuaja të pambukta (çarçafët, mbulesat e krevatit, peshqirët, rrobat e banjës.)

• Sintetiket

Me këtë program lani rrobat që nuk janë shumë rezistuese. Rekomandohet në përdorim për rrobat tuaja sintetike.

5.6 Programet shtesë

Programet shtesë në vijim janë në dispozicion në pajisjen tuaj për kushte të veçanta.



Programet shtesë mund të ndryshojnë sipas specifikimeve të pajisjes tuaj.



Me qëllim që të siguron rezultate më të mira me programet e tharjes së pajisjes, rrobat tuaja duhet të lahen me programin e përshtatshëm në makinën tuaj larëse dhe të shtrydhen me mënyrën e rekomanduar të shtrydhjes.

• Xhinset

Përdoret për të tharë xhinset që shtrydhen me centrifugim të lartë në makinën larëse.

• Sportivet

Përdoret për të tharë rroba të cilat janë sintetike, të pambukta apo pëlhura të përziera dhe kanë etiketë që tregojnë se janë të përshtatshme për t'u tharë.

• Këmisha 15

Than në mënyrë më delikate këmishat dhe krijon më pak rrudha duke lehtësuar hekurosjen.

• BabyProtect

Program që përdoret për rrobat e bebeve të cilat mbajnë etiketën që tregon se mund të thahen në tharëse.



Pas këtij programi do të mbetet pak lagështi te këmishat. Rekomandohet që të mos i lini këmishat në pajisjen tharëse.

Vënia në punë e produktit

- **Delikatet**

Mund të thani rrobat tuaja shumë delikate të cilat janë të përshtatshme për t'u tharë apo rrobat të cilat këshillohen të lahen me dorë në temperatura të ulëta.



Rekomandohet që të përdoret një qese pëlhure për të parandaluar që rrobat delikate të rrudhosen apo të dëmtohen. Pasi programi të përfundojë, nxirrini menjëherë rrobat jashtë nga pajisja dhe varini me qëllim që të parandaloni rrudhosjen.

- **Freskimi**

Kryen vetëm ajrim për 10 minuta pa fryrë ajër të nxehtë. Mund të ajrosni rrobat tuaja të pambukta dhe të linjtë që kanë qëndruar të mbyllura për një kohë të gjatë dhe t'i hiqni aromën e pakëndshme.

- **Programet me kohëmatës**

Mund të përzgjidhni një prej programeve me kohëmatës me 10 min., 20 min., 40 min., dhe 60 min. për të arritur nivelin përfundimtar të dëshiruar në temperatura të ulëta.



Në këtë program pajisja than për aq kohë sa është vendosur kohëzgjatja, pavarësisht nga niveli i tharjes.

Vënia në punë e produktit

5.7 Përzgjedhja e programit dhe tabela e konsumit

AL					
Programet		Kapaciteti (kg)	Shpejtësia e rrotulimit në lavatriçe (rrotullime/min)	Sasia me përafërsi e lagështisë së mbetur	Koha e tharjes (minuta)
Pambuku / me ngjyra					
	Tharja shitesë	7	1000	% 60	124
	Të thara për në dollap	7 / 3,5	1000	% 60	116 / 68
	Tharje me hekur	7	1000	% 60	90
Këmisha 15		1,5	1200	% 60	15
Xhinset		4	1200	%50	80
Sportivet		4	1000	%60	92
Delikatet		2	600	%40	40
Babyprotect		3	1000	% 60	65
Sintetiket					
	Të thara për në dollap	3,5	800	% 40	45
	Të thara për në dollap	3,5	800	% 40	35
Vlerat e konsumit të energjisë					
Programet		Kapaciteti (kg)	Shpejtësia e rrotulimit në lavatriçe (rrotullime/min)	Sasia me përafërsi e lagështisë së mbetur	Vlerat e konsumit të energjisë në kwh
Veshjet e pambukta gati për t'u veshur*		7 / 3,5	1000	% 60	4,17 / 2,34
Veshjet e pambukta gati për hekurosje		7	1000	% 60	3,25
Veshjet sintetike gati për t'u veshur		3,5	800	% 40	1,42
Konsumi i energjisë në modalitetin joaktiv për programin standard të veshjeve të pambukta me ngarkesë të plotë, PO (W)					0,5
Konsumi i energjisë në modalitetin aktiv për programin standard të veshjeve të pambukta me ngarkesë të plotë, PL (W)					1,0



„Programi i thatë i raftit të veshjeve të pambukut” i përdorur me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme është programi standard i tharjes me të cilin lidhen informacionet në etiketë dhe në skedën e të dhënave - ky program është i përshtatshëm për tharjen e rrobave normale të lagura prej pambuku dhe ai është programi më efikas në kuadër të konsumit të energjisë për veshjet e pambukut.

* : Etiketa e energjisë për programin standard (EN 61121:2012) “Të gjitha filtrat duhet të jenë pastruara para se të kryhet seria e testeve.”

Të gjitha vlerat e dhëna në tabelë janë vendosur sipas standardit EN 61121:2012. Vlerat e konsumit mund të ndryshojnë nga vlerat në tabelë në varësi të llojit të rrobave, shpejtësisë së centrifugimit të rrobave, kushteve mjedisore dhe luhatjeve të tensionit.

5.8 Funksonet ndihmëse

Anulimi i paralajmërimit me tingull

Pajisja tharëse lëshon një tingull paralajmërues kur programi përfundon. Nëse nuk dëshironi tingull njoftues, shtypni butonin "Njoftimi me tingull".

Kur shtypni butonin e njoftimit me tingull ai ndizet dhe programi nuk lëshon më njoftim me tingull kur përfundon.



Këtë funksion mund ta përzgjidhni para ose pasi programi të ketë nisur.


5.9 Simbolet paralajmëruese



Simbolet paralajmëruese mund të ndryshojnë sipas specifikimeve të pajisjes tuaj.

Pastrimi i filtrit të fibrës

Kur programi përfundon, ndizet një dritë paralajmëruese e cila tregon se filtri duhet të pastrohet.



Nëse drita e pastrimit të filtrit dridhet, shihni kapitullin „Zgjidhja e problemeve”.

Depozita e ujit

Kur programi përfundon, ndizet një dritë paralajmëruese e cila tregon se duhet të zbrazet depozita e ujit.

Nëse depozita e ujit mbushet ndërsa programi është në punë, drita paralajmëruese nis të dridhet dhe pajisja kalon në gjendjen e gatishmërisë. Në këtë rast zbrazeni ujin nga depozita dhe nisni programin duke shtypur butonin Nis / Pezullo. Drita paralajmëruese fiket dhe programi rinis.



Dera e ngarkimit hapur

Drita Nis/Pezullo dridhet kur dera e ngarkimit e pajisjes tharëse është e hapur.

5.10 Kohëzgjatja për përfundimin

Mund të shtyni kohëzgjatjen për përfundimin e programit deri në 24 orë nëpërmjet funksionit të kohëzgjatjes për përfundimin.

1. Hapni derën e ngarkimit dhe vendosni rrobat.
2. Përzgjidhni programin e tharjes.
3. Shtypni butonin e përzgjedhjes së kohëzgjatjes për përfundimin dhe vendosni shtyrjen e kohëzgjatjes që dëshironi. Ndizet drita e kohëzgjatjes për përfundimin. (Kohëzgjatja për përfundimin lëviz vazhdimisht kur vazhdoni të shtypni butonin).
4. Shtypni butonin Nis / Pezullo. Fillon numërimi mbrapsht i kohëzgjatjes për përfundimin. Shenja “:” në mes të kohëzgjatjes së shfaqur të shtyrjes dridhet.



Mund të shtoni dhe të hiqni rroba gjatë kohëzgjatjes për përfundimin. Kohëzgjatja e shfaqur në ekran është shuma e kohëzgjatjes normale të tharjes dhe kohëzgjatjes për përfundimin. Në fund të numërimit mbrapsht, drita e kohëzgjatjes për përfundimin fiket, fillon tharja dhe ndizet drita e saj.

Vënia në punë e produktit

Ndryshimi i kohëzgjatjes për përfundimin

Nëse dëshironi të ndryshoni kohëzgjatjen gjatë numërimit mbrapsht:

1. Anuloni programin duke shtypur butonin Aktiv/Joaktiv. Ndizeni sërish pajisjen tharëse duke shtypur butonin Aktiv/Joaktiv. Kur pajisja juaj tharëse ndizet për herë të parë, ndizet me programin (thatësia e gardërobës së pambuktë) e deklarimit.
2. Përzgjidhni programin që dëshironi duke përdorur çelësin e përzgjedhjes së programit.
3. Përsëritni veprimin e kohëzgjatjes për përfundimin për kohëzgjatjen që dëshironi.
4. Nisni programin duke shtypur butonin Nis / Pezullo.

Anulimi i funksionit të kohëzgjatjes për përfundimin

Nëse dëshironi të anuloni numërimin mbrapsht të funksionit të kohëzgjatjes për përfundimin dhe të nisni menjëherë programin:

1. Anuloni programin duke shtypur butonin Aktiv/Joaktiv. Ndizeni sërish pajisjen tharëse duke shtypur butonin Aktiv/Joaktiv. Kur pajisja juaj tharëse ndizet për herë të parë, ndizet me programin (thatësia e gardërobës së pambuktë) e deklarimit.
2. Përzgjidhni programin që dëshironi duke përdorur çelësin e përzgjedhjes së programit.
3. Nisni programin duke shtypur butonin Nis / Pezullo.

5.11 Nisja e programit

Nisni programin duke shtypur butonin Nis / Pezullo.

Drita Nis/Pezullo dhe drita e Tharjes ndizet për të treguar që programi nisi. Shenja “.” në mes të kohëzgjatjes së mbetur fillon të dridhet.

5.12 Kycja për fëmijët

Pajisja ka kycje për fëmijët e cila parandalon që rrjedha e programit të pajisjes të ndikohet kur butonat e saj shtypen gjatë kohës që ajo është në punë.

Kur kycja për fëmijët është e aktivizuar, të gjithë butonat përveç butonit Aktiv/Joaktiv janë të çaktivizuar.

Për të aktivizuar kycjen për fëmijët shtypni njëkohësisht për 3 sekonda butonin e Njoftimit me tingull dhe Kohëzgjatjes për përfundimin.

Kycja për fëmijët duhet të çaktivizohet që të jemi në gjendje të nisim një program tjetër pasi programi aktual të përfundojë apo të jemi në gjendje që të ndërhyjmë në programin aktual. Mbajini shtypur sërish për 3 sekonda të njëjtët butona për të çaktivizuar kycjen për fëmijët.



Kur të aktivizohet kycja për fëmijët në ekran do të ndizet drita e kycjes.



Kycja për fëmijët çaktivizohet kur pajisja fiket dhe ndizet sërish duke përdorur butonat Aktiv/Joaktiv.

Dëgjohet një tingull paralajmërues kur shtypet ndonjë buton (përveç butonit Aktiv/Joaktiv) apo kur çelësi i përzgjedhjes së programit rrotullohet ndërsa është aktive kycja për fëmijët.

5.13 Ndryshimi programit pasi ai ka nisur

Pasi pajisja të fillojë punën, mund ta ndryshoni programin që keni zgjedhur për të tharë rrobat me një program tjetër.

1. Për shembull, për të zgjedhur programin Tharje shtesë në vend të Të thata për hekurosje, ndalni programin duke shtypur butonin Nis / Pezullo.
2. Rrotulloni çelësin e përzgjedhjes së programit për të përzgjedhur programin Tharje shtesë.
3. Nisni programin duke shtypur butonin Nis / Pezullo.

Vënia në punë e produktit

Shtimi dhe heqja e rrobave në modalitetin e gatishmërisë

Nëse dëshironi të shtoni apo hiqni rroba pasi programi i tharjes të ketë nisur:

1. Shtypni butonin Nis/Pezullo për ta kaluar pajisjen në modalitetin e gatishmërisë. Procesi i tharjes ndërpritet.
2. Hapni derën e ngarkimit, shtoni apo hiqni rroba dhe mbylleni sërish.
3. Nisni programin duke shtypur butonin Nis / Pezullo.



Shtimi i rrobave i kryer pas nisjes së punës për tharjen mund të shkaktojë përzierjen e rrobave të thara brenda në pajisje me rrobat e lagura dhe që rrobat të mbeten të lagura pasi të përfundojë puna për tharjen.



Shtimi dhe heqja e rrobave mund të përsëritet sa herë të dëshironi gjatë procesit të tharjes. Por ky proces do të ndërpresë vazhdimisht punën për tharjen, dhe kjo do të shkaktojë rritjen e kohëzgjatjes së programit dhe konsumit të energjisë. Prandaj, rekomandohet që rrobat të shtohen përpara se të ketë nisur programi i tharjes.



Nëse përzgjidhet një program i ri duke ndryshuar pozicionin e çelësit të përzgjedhjes së programit ndërsa pajisja është në modalitetin e gatishmërisë, programi në proces përfundon.



Mos e prekni sipërfaqen e brendshme të kazanit kur shtoni apo hiqni rroba gjatë një programi në proces. Sipërfaqja e kazanit është e nxehtë.

5.14 Anulimi i programit

Nëse për ndonjë arsye dëshironi të anuloni programin dhe të përfundoni procesin e tharjes pasi pajisja të ketë nisur punën, shtypni butonin Aktiv/Joaktiv.



Meqenëse pjesa e brendshme e pajisjes do të jetë tepër e nxehtë kur anuloni programin ndërsa ajo është në punë, aktivizoni programin e ajrosjes që ajo të ftohet.

5.15 Përfundimi i programit

Kur programi përfundon, dritat e Parandalimit Përfundimtar/Të rrudhave, Pastrimit të filtrit të fibrës dhe Paralajmërimit të depozitës së ujit do të ndizen në treguesin e programit në vazhdim. Dera e ngarkimit mund të hapet dhe pajisja bëhet gati për një proces të dytë. Shtypni butonin Aktiv/Joaktiv për të fikur pajisjen.



Nëse nuk i nxirrni rrobat jashtë pasi programi të ketë përfunduar, do të nisë programi i parandalimit të rrudhave i cili zgjat 2 orë me qëllim që të parandalojë rrudhosjen e rrobave që qëndrojnë brenda në pajisje.



Pastroni filtrin e fibrës pas çdo tharjeje. (Shihni „Filtër i fibrës dhe sipërfaqja e brendshme e derës së ngarkimit“)



Zbrazni depozitën e ujit pas çdo tharjeje. (Shihni „Zbrazja e depozitës së ujit“)

6 Mirëmbajtja dhe pastrimi

Jeta e shërbimit të produktit rritet dhe problemet e hasura shpesh do të reduktohen nëse ai pastronet në intervale të rregullta të kohës.

6.1 Pastrimi i filtrit të linjtë / sipërfaqes së brendshme të derës së ngarkimit

Pushi dhe fibrat e lëshuara në ajër nga rrobat gjatë ciklit të tharjes grumbullohen në filtrin e linjtë.



Të tilla fibra dhe pushe zakonisht krijohen gjatë veshjes dhe larjes.







Pastroni gjithmonë filtrin e linjtë dhe sipërfaqet e brendshme të derës së ngarkimit pas çdo cikli të tharjes.




Folenë e filtrit të linjtë mund ta pastroni duke përdorur një fshesë me korrent.

Për të pastruar filtrin e linjtë:



- Hapni derën e ngarkimit.
- Hiqni filtrin e linjtë duke e tërhequr lart dhe hapeni.
- Pastroni pëlhurën e linjtë, fibrën dhe fijet e pambukta me dorë ose me një copë pëlhere të butë.
- Mbyllni filtrin e linjtë dhe vendoseni përsëri në folenë e tij.



- Në poret e filtrit mund të krijohet një shtresë e cila mund të shkaktojë bllokim të filtrit pas përdorimit të tharëses për një kohë të caktuar. Lajeni filtrin e linjtë me ujë të ngrohtë për të hequr shtresën që krijohet në sipërfaqen e tij. Thajeni plotësisht filtrin e linjtë përpara se ta vendosni sërish.



- Pastroni të gjithë sipërfaqen e brendshme të derës së ngarkimit dhe guarnicionin e derës së ngarkimit me një copë pëlhere të njomë.



6.2 Pastrimi i sensorit

Brenda në tharëse ka sensorë për lagështinë të cilët tregojnë nëse rrobat janë tharë apo jo.

Për të pastruar sensorët:

- Hapni derën e ngarkimit të tharëses.
- Lëreni pajisjen të ftohet nëse është ende e nxehtë për shkak të procesit të tharjes.
- Fshini sipërfaqet metalike të sensorit me një pëlhurë të butë, të shuar me uthull, dhe thajeni atë.




Pastroni sipërfaqet metalike të sensorëve 4 herë në vit.



Mos përdorni vegla metalike kur pastroni sipërfaqet metalike të sensorëve.



Mos përdorni asnjëherë tretës, agjentë pastrimi apo substanca të ngjashme për pastrim për shkak të rrezikut të zjarrit dhe shpërthimit.



6.3 Zbrazja e depozitës së ujit

Gjatë procesit të tharjes, lagështia e rrobave largohet e kondensohet dhe uji që krijohet grumbullohet në depozitën e ujit. Zbrazeni depozitën e ujit pas çdo cikli të tharjes.



Uji i kondensuar nuk është i pijshëm!




Mos e hiqni asnjëherë depozitën e ujit kur programi është në punë.


Nëse harroni që të zbrazni depozitën e ujit, pajisja do të ndalojë gjatë cikleve pasuese të tharjes kur ajo të jetë plot dhe do të ndizet simboli i depozitës së ujit. Nëse ndodh ky rast, zbrazni depozitën e ujit dhe shtypni butonin Nis / Pezullo për të rifilluar procesin e tharjes.

Për të zbrazur depozitën e ujit:

- Tërhiqni sirtarin dhe hiqni me kujdes ujin nga depozita.



- Zbrazni ujin nga depozita.



- Nëse ka grumbullim të pusheve në gypin e depozitës së ujit, pastrojini me ujë të rrjedhshëm.
- Vendoseni depozitën e ujit në vendin e saj.



Nëse përdoret si option shkarkimi i drejtpërdrejtë i ujit, nuk ka arsye që të zbrazni depozitën e ujit.

Mirëmbajtja dhe pastrimi

6.4 Pastrimi i kondensatorit;


Ajri i nxehtë dhe i lagësht në kondensator ftohet nëpërmjet ajrit të ftohtë të dhomës. Prandaj, ajri i lagësht që qarkullon në tharësen tuaj kondensohet dhe pastaj dërgohet me pompë në depozitë.




Pastrojeni kondensatorin pas çdo 30 cikleve të tharjes ose një herë në muaj.

Për të pastruar kondensatorin:


1. Nëse është kryer një proces i tharjes, hapni derën e ngarkimit të pajisjes dhe prisni derisa ajo të ftohet.




2. Zbërtheni dy mbërthyeset e kondensatorit pasi të hapni pllakëzën metalike mbrojtëse.




3. Tërhiqni kondensatorin.




4. Pastroni kondensatorin duke përdorur ujë me presion me një dush me rotor dhe prisni derisa uji të thahet.



5. Vendoseni kondensatorin në folenë e tij. Mbyllni 2 mbërthyeset dhe sigurohuni që ato të janë vendosur në mënyrë të sigurt.



6. Mbyllni kapakun e pllakëzës metalike mbrojtëse.



7 Zgjidhja e problemeve

Procesi i tharjes kërkon shumë kohë.

- Poret e filtrit të linjtë janë të bllokuara. > > > Lajeni filtrin e linjtë me ujë të ngrohtë.
- Mund të jetë bllokuar kondensatori. > > > Pastroni kondensatorin.
- Rrjeta e ajrimit në pjesën ballore të pajisjes është bllokuar. > > > Hiqni sendet (nëse ka) që bllokojnë ajrosjen në pjesën ballore të rrjetës së ajrimit.
- Ajrimi mund të mos jetë i mjaftueshëm pasi dhoma ku është instaluar pajisja është shumë e vogël. > > > Hapni derën dhe dritaren e dhomës për të shmangur rritjen e madhe të temperaturës së dhomës.
- Janë krijuar depozitime gëlqerore te sensori i lagështisë. > > > Pastroni sensorin e lagështisë.
- Mund të jetë ngarkuar sasi e tepërt e rrobave. > > > Mos e mbushni tharësen më shumë se ç'duhet.
- Rrobat mund të mos jenë centrifuguar sa ç'duhet. > > > Centrifugojini rrobat tuaja me një shpejtësi më të madhe në makinën tuaj larëse.

Rrobat dalin të lagura në fund të tharjes.



Pas tharjes, rrobat e nxehta duken të njoma më tepër sesa niveli i tyre i vërtetë i lagështisë.

- Mund të mos jetë përdorur programi i duhur për llojin e rrobave. > > > Kontrolloni etiketën e veshjes dhe përzgjidhni një program të përshtatshëm për llojin e pëlhurës ose përdorni programet shtesë me kohëmatës.
- Poret e filtrit të linjtë janë të bllokuara. > > > Lajeni filtrin e linjtë me ujë të ngrohtë.
- Mund të jetë bllokuar kondensatori. > > > Pastroni kondensatorin.
- Mund të jetë ngarkuar sasi e tepërt e rrobave. > > > Mos e mbushni tharësen më shumë se ç'duhet.
- Rrobat mund të mos jenë centrifuguar sa ç'duhet. > > > Centrifugojini rrobat tuaja me një shpejtësi më të madhe në makinën tuaj larëse.

Tharësja nuk ndizet apo programi nuk fillon. Tharësja nuk fillon punën kur është në rregull.

- Mund të mos jetë vendosur në prizë. > > > Sigurohuni që pajisja të jetë vendosur në prizë.
- Dera e ngarkimit nuk është e mbyllur plotësisht. > > > Sigurohuni që dera e ngarkimit të jetë e mbyllur siç duhet.
- Nuk është përzgjedhur programi ose nuk është shtypur butoni Nis / Pezullo. > > > Sigurohuni që është përzgjedhur programi dhe pajisja nuk është në modalitetin Pezullo.
- Mund të jetë aktivizuar "Kycja për fëmijët". > > > Çaktivizoni kycjen për fëmijët.

Programi ndërpritet pa ndonjë shkak.

- Dera e ngarkimit mund të mos jetë mbyllur siç duhet. > > > Sigurohuni që dera e ngarkimit të jetë e mbyllur siç duhet.
- Mund të ketë ndodhur një ndërprerje e energjisë. > > > Shtypni butonin Nis / Pezullo për të nisur programin.
- Depozita e ujit mund të jetë e mbushur plot. > > > Zbrazni depozitën e ujit.

Rrobat hyjnë në ujë, lidhen apo prishen.

- Mund të mos jetë përzgjedhur një program i përshtatshëm për llojin e rrobave. > > > Kontrolloni etiketën e veshjes dhe përzgjidhni programin e përshtatshëm për llojin e pëlhurës.

Zgjidhja e problemeve

Drita e kazanit nuk ndizet. (në modelet me llambë)

- Tharësja mund të mos jetë ndezur me butonin Aktiv / Joaktiv / Anulo. > > > Sigurohuni që tharësja të jetë e ndezur.
- Poçi mund të jetë djegur. > > > Për të ndërruar llambën telefonojini agjentit të shërbimit të autorizuar.

Drita e simbolit njoftues për pastrimin e filtrit është e ndezur.

- Nuk është pastruar filtri i linjtë. > > > Pastroni filtrin e linjtë.

Simboli i pastrimit të filtrit të linjtë shkëlqen.

- Foleja e filtrit është e bllokuar nga pushet. > > > Pastroni folenë e filtrit të linjtë.
- Është krijuar një depozitim në poret e filtrit të linjtë i cili mund të shkaktojë bllokimin. > > > Lajeni filtrin e linjtë me ujë të ngrohtë.
- Mund të jetë bllokuar kondensatori. > > > Pastroni kondensatorin.

Rrjedh ujë nga dera e ngarkimit.

- Është grumbulluar push në sipërfaqet e brendshme të derës së ngarkimit dhe sipërfaqet e guarnicionit të derës së ngarkimit. > > > Pastroni sipërfaqet e brendshme të derës së ngarkimit dhe sipërfaqet e guarnicionit të derës së ngarkimit.

Dera e ngarkimit hapet vetë.

- Dera e ngarkimit mund të mos jetë mbyllur siç duhet. > > > Shtyjeni derën e ngarkimit derisa të dëgjoni tingullin e mbylljes.

Simboli i depozitës së ujit është i ndezur/shkëlqen.


- Depozita e ujit mund të jetë e mbushur plot. > > > Zbrazni depozitën e ujit.
- Tubi i shkarkimit të ujit mund të jetë i përthyer. > > > Nëse produkti është i lidhur drejtpërdrejt me tubin e ujit të papastër, kontrolloni tubin e shkarkimit të ujit.

Simboli njoftues për pastrimin e kondensatorit shkëlqen.

- Mund të mos jetë pastruar kondensatori. > > > Pastroni kondensatorin.



KUJDES: Nëse nuk mundeni që ta eliminoni problemin megjithëse ndiqni udhëzimet në këtë pjesë, kontaktoni me shitësin ose agjentin e shërbimit të autorizuar. Mos u përpiqni asnjëherë që të riparoni vetë një produkt që nuk funksionon



www.beko.com